



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

**RREGULLORE NR. 01/2025 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KOSOVËS TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut, nenit 9 të Statutit të Qendrës Kombëtare të Kosovës të Transfuzionit të Gjakut, datë 28.12.2024 dhe përshtatshmërisht me Rregulloren (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, miraton:

RREGULLORE NR. 01/2025 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË QENDRËN KOMBËTARE TË KOSOVËS TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Qendrën Kombëtare të Kosovës të Transfuzionit të Gjakut (në tekstin në vazhdim QKKTGj).

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet në Qendrën Kombëtare të Kosovës të Transfuzionit të Gjakut.

**Neni 3
Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termat dhe shprehjet e përdorura kanë kuptimin e përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligjin Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut dhe legjislacionin përkatës.

**Neni 4
Përgjegjësitë e QKKTGj-së**

Përgjegjësitë e QKKTGj-së janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligjin Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut, Statutin e QKKTGj-së dhe këtë Rregullore.

**KAPITULLI II
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I ADMINISTRATËS SË QKKTGj-së**

**Neni 5
Misioni i QKKTGj-së**

Misioni i Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGj) është të sigurojë

grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut dhe përbërësve të tij, për të plotësuar nevojat e pacientëve të ndryshëm për transfuzion të sigurt dhe efektiv. QKKTGj ka për qëllim të garantojë furnizimin e qëndrueshëm dhe të sigurt me gjak dhe përbërës të gjakut, duke përmbushur standardet ndërkombëtare për cilësinë dhe sigurinë e dhuruesve dhe marrësve të gjakut.

Neni 6 **Administrata e QKKTGj-së**

1.Funksionet administrative, financiare dhe mbështetëse organizohen dhe realizohen nga administrata qendrore e QKKTGj-së e vendosur në Prishtinë e cila ofron shërbime edhe për Qendrat e Transfuzionit të Gjakut (QTGj) të cilat janë degët rajonale dhe njësi përbërëse të QKKTGj-së.

2.Përfshihet nga parafi 1 i këtij neni, në degët (qendrat) rajonale të QKKTGj-së mund të ketë staf për ushtrimin e funksioneve të përcaktuara si në paragrafi 1 të këtij neni, i cili miratohet paraprakisht nga Drejtori Ekzekutiv i QKKTGj-së dhe menaxhohen nga divizionet përkatëse të administratës qendrore të QKKTGj-së.

Neni 7 **Struktura Organizative e QKKTGj-së**

1.QKKTGj drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe përbëhet nga strukturat si në vijim:

1.1.Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2.Departamentet; dhe

1.3.Divizionet

2.QKKTGj ka degët (qendrat) rajonale, të organizuara si Qendrat e Transfuzionit të Gjakut (QTGj), të cilat në aspektin e organizimit dhe klasifikimit të pozitive, janë të barasvlershme me departamentet brenda QKKTGj-së.

3.Numri i të punësuarve në QKKTGj, përfshirë QTGj-të është njëqindetëmbëdhjetënjë (181).

Neni 8 **Zyra e Drejtorit Ekzekutiv**

1.Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet, si në vijim:

1.1.Drejtori i Ekzekutiv;

1.2.Zyrtar i Lartë Ekzekutiv;

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me legjislacionin përkatës dhe Statutin e QKKTGj-ës.

3.Drejtori Ekzekutiv është nëpunës i shërbimeve publike i nivelit të lartë drejtues, është zyrtari kryesor administrativ, i cili i raporton Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë.

4.Drejtori Ekzekutiv për çështje arsimore dhe shkencore mund të ndihmohet nga Drejtori për Arsim

dhe Shkencë i cili propozohet nga fakulteti përkatës i shkencave mjekësore dhe emërohet nga Drejtori Ekzekutiv i QKKTGj -së.

5.Funksioni i Drejtorit për arsim dhe shkencë është funksion shtesë i profesorit të caktuar në këtë pozitë dhe kompensohet sipas legjislacionit për pagat në Divizionin publik të përcaktuar për kompensimin e funksioneve shtesë.

6.Emërimi, mandati dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet me legjislacionin për Zyrtarët Publik.

7.Në varësinë e Drejtorit Ekzekutiv janë edhe pozitat e punës:

7.1.Zyrtar i Lartë i Certifikimit

8.Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është tre (3).

Neni 9

Departamentet dhe divizionet në QKKTGj

1.Departamentet dhe divizionet e QKKTGj-së, janë:

1.1. Departamenti për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut:

1.1.1.Divizioni për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve;

1.1.2.Divizioni për Grumbullimin e Gjakut;

1.2. Departamenti për Aferezë:

1.2.1.Divizioni për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë;

1.2.2.Divizioni për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit.

1.3.Departamenti për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut:

1.3.1.Divizioni për Ndarje Konvencionale të Gjakut;

1.3.2.Divizionit për Ndarje Speciale të Gjakut dhe Zinxhirin e Ftoftë.

1.4.Departamenti për Transfuzion Klinik të Gjakut:

1.4.1.Divizioni për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut;

1.4.2.Divizioni për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut;

1.5. Departamenti për Imunohematologji:

1.5.1.Divizioni për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut;

1.5.2.Divizioni për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike;

1.6. Departamenti për Sëmundjet e Transmetueshme:

1.6.1. Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhurueseve të Gjakut;

1.6.2. Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve.

1.7. Departamenti i Testimeve Prenatale:

1.7.1. Divizioni për Testime Prenatale;

1.7.2. Divizioni për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik.

1.8. Departamenti për Hemostazë:

1.8.1. Divizioni për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative;

1.8.2. Divizioni për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut.

1.9. Departamenti për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut:

1.9.1. Divizioni për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë;

1.9.2. Divizioni për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT.

1.10. Departamenti për Infermieri:

1.10.1. Divizioni i Infermierisë në QKKTGj;

1.10.2. Divizioni i Infermierisë në Qendrat e Transfuzionit të Gjakut.

1.11. Qendrat e Transfuzionit të Gjakut në kuadër të QKKTGj-së:

1.11.1. QTGj Mitrovicë;

1.11.2. QTGj Pejë

1.11.3. QTGj Gjakovë;

1.11.4. QTGj Prizren;

1.11.5. QTGj Gjiilan;

1.11.6. QTGj Ferizaj;

1.11.7. QTGj Vushtri.

1.12. Divizioni për Shërbime të Përbashkëta.

1.13. Divizioni për Burime Njerëzore.

1.14.Divizioni për Buxhet dhe Finance

1.15.Divizioni Ligjor.

1.16.Divizioni për Prokurim Publik.

Neni 10

Departamenti për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut

1.Misioni i Departamentit për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut është të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt të gjakut për nevojat shëndetësore të popullatës, përmes planifikimit, grumbullimit dhe promovimit të dhurimit, ndërgjegjësimit qytetar, organizimit të fushatave dhe aktiviteteve edukative, si dhe garantimit të një sistemi të sigurt të menaxhimit.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut, janë:

2.1.Planifikimi strategjik dhe analizimi i nevojave kombëtare për gjak dhe përbërës të gjakut, për të siguruar një mbulim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të kërkesave të popullatës;

2.2.Planifikimi, organizimi dhe mbikëqyrja e aksioneve vullnetare për dhurim të gjakut, duke përfshirë fushatat kombëtare dhe lokale që nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve;

2.3.Organizimi dhe grumbullimi i gjakut përmes ekipeve mobile në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke garantuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara;

2.4.Motivimi, vetëdijësi dhe këshillimi i popullatës për dhurimin vullnetar të gjakut, duke përdorur metoda të ndryshme komunikimi dhe edukimi për të rritur përfshirjen e dhuruesve;

2.5.Zhvillimi i partneriteteve dhe bashkëpunimi me institucionet publike dhe jopublike, për të organizuar aksione të përbashkëta vullnetare dhe për të këshilluar dhe rekrutuar dhurues të rinj;

2.6.Promovimi i dhurimit të gjakut përmes bashkëpunimit të ngushtë me media dhe institucionet përkatëse, për të informuar dhe edukuar publikun mbi rëndësinë e dhurimit të gjakut;

2.7.Përzgjedhja dhe kontrolli i dhuruesve të gjakut, si dhe menaxhimi dhe raportimi i reaksioneve të padëshiruara gjatë procesit të dhurimit, për të siguruar sigurinë dhe mirëqenien e dhuruesve;

2.8.Planifikimi strategjik për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve që rrisin sigurinë dhe cilësinë e dhurimit të gjakut, duke zbatuar praktikat më të mira ndërkombëtare;

2.9.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatës të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

2.10.Hartimi dhe zbatimi i planeve zhvillimore për përmirësimin e shërbimeve dhe arritjen e objektivave strategjike;

2.11. Zhvillimi dhe organizimi i programeve të rregullta për edukim dhe trajnime për stafin, për të siguruar ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe përputhjen me teknologjitë dhe praktikat më të fundit në fushën e dhurimit të gjakut.

3. Departamenti për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.

4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:

4.1. Divizioni për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve;

4.2. Divizioni për Grumbullimin e Gjakut;

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut, është njëmbëdhjetë (11).

Neni 11

Divizioni për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve, janë:

1.1. Hartimi dhe zhvillimi i planeve strategjike për mbulimin e nevojave kombëtare për gjak dhe përbërës të gjakut, për të siguruar një rezervë të qëndrueshme në vend;

1.2. Organizimi dhe menaxhimi i fushatave kombëtare dhe lokale për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut, duke i informuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve për dhurimin e gjakut;

1.3. Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimeve strategjike me institucione publike dhe jopublike për organizimin e aksioneve të përbashkëta për dhurimin e gjakut;

1.4. Ndërtimi i partneriteteve me media dhe institucione të tjera për të promovuar dhurimin e gjakut, përmes fushatave edukative dhe ndërgjegjëse;

1.5. Krijimi dhe menaxhimi i materialeve promovuese dhe edukative për dhurimin e gjakut si dhe koordinimi i aktiviteteve të edukimit publik për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të rekrutuar dhurues të rinj;

1.6. Vetëdijësimi dhe promovimi i rëndësisë së dhurimit vullnetar të gjakut në popullatë, përmes fushatave informuese, aktiviteteve edukative dhe bashkëpunimit me institucionet përkatëse;

1.7. Monitorimi i ueb faqes zyrtare të QKKTGj dhe llogarive të saj në rrjetet sociale, për të ofruar informacion të përditësuar mbi rëndësinë e dhurimit të gjakut;

1.8. Planifikimi, promovimi dhe organizimi i aktiviteteve për grumbullimin e gjakut, përfshirë organizimin e ekipeve mobile shtesë, dhe pjesëmarrja në punën e tyre;

1.9. Këshillimi dhe edukimi i dhuruesve të rinj dhe të përsëritur mbi procesin e dhurimit dhe

përfitimet e tij, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të inkurajuar dhurimet e ardhshme;

1.10.Sigurimi i informimit dhe komunikimi me dhuruesit mbi procesin e dhurimit të gjakut, përfshirë kriteret, përfitimet dhe rreziqet, si dhe trajtimin e shqetësimeve të tyre;

1.11.Grumbullimi dhe evidentimi i të dhënave mbi dhurimet me rezultat reaktiv të raportuara nga Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut, Divizioni për Testimin Molekular në Sëmundjet Infektive (NAT) dhe Divizioni për Testimin Immunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut;

1.12.Njoftimi i dhuruesit të gjakut dhe thirrja për ri-testim në përputhje me algoritmin e testimit serologjik, algoritmin e testimit molekular (NAT) dhe algoritmin e testimit imunohematologjik;

1.13.Përgatitja e planit vjetor të aktiviteteve të dhurimit të gjakut në nivel vendi, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.Divizioni për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve është tre (3).

Neni 12

Divizioni për Grumbullimin e Gjakut

1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Grumbullimin e Gjakut, janë:

1.1.Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve për grumbullimin e gjakut në nivel vendi, në bashkëpunim me Divizionin për Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut;

1.2.Menaxhimi dhe koordinimi i logjistikës, përfshirë pajisjet dhe materialet për grumbullimin e gjakut;

1.3.Mbikëqyrja e zbatimit të standardeve të cilësisë dhe sigurisë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të gjakut në terren dhe institucionin e autorizuar transfuziv, për të garantuar sigurinë e dhuruesve dhe të përbërësve të gjakut;

1.4.Raportimi i të dhënave mbi sasinë e gjakut të grumbulluar, përfshirë aktivitetet e grumbullimit në terren nga ekipet mobile, si dhe përgatitja e statistikave për qëllime analitike dhe raportuese;

1.5.Përzgjedhja e dhuruesve si dhe monitorimi, menaxhimi dhe raportimi i reaksioneve të padëshiruara;

1.6.Komunikimi dhe koordinimi me divizionet e tjerë për angazhimin e stafit për grumbullimin e gjakut në terren dhe në qendër të Transfuzionit;

1.7.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatës të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

- 1.8.Koordinimi i aktiviteteve me Divizionin Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve, për të siguruar që të gjithë dhuruesit të përmbushin kriteret e përshtatshmërisë;
- 1.9.Përgatitja e planit vjetor të grumbullimit të gjakut në nivel vendi, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;
- 2.Divizioni për Grumbullimin e Gjakut udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Grumbullimin, Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit të Gjakut.
- 3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Grumbullimin e Gjakut, është gjashtë (6).

Neni 13

Departamenti për Aferezë

- 1.Misioni i Departamentit për Aferezë është të sigurojë grumbullimin dhe furnizimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe cilësor të përbërësve të veçantë të gjakut, si plazma, trombocitet, eritrocitet dhe përbërës të tjerë, duke përdorur teknologjinë e avancuar të aferezës për grumbullimin e tyre nga dhuruesit dhe duke garantuar që ato plotësojnë kriteret e nevojshme për trajtimin e pacientëve që kërkojnë transfuzion të produkteve specifike të gjakut.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Aferezë, janë:
- 2.1.Planifikimi strategjik për nevojat kombëtare për përbërës specifikë të gjakut të përfituar përmes aferezës, duke u bazuar në kërkesat klinike dhe kapacitetet e furnizimit;
- 2.2.Motivimi, vetëdijesimi dhe ofrimi i këshillimit për popullatën lidhur me dhurimin e përbërësve të caktuar të gjakut përmes aferezës;
- 2.3.Grumbullimi i përbërësve të veçantë të gjakut përmes aferezës, si plazma, trombocitet dhe qelizat e tjera, në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë.
- 2.4.Rekrutimi i dhuruesve të përshtatshëm për aferezë në përputhje me standardet mjekësore dhe sigurimin e informacionit të qartë për procesin dhe përfitimet e aferezës;
- 2.5.Rekrutimi i dhuruesve dhe pacientëve të përshtatshëm, përfshirë identifikimin dhe përzgjedhjen e dhuruesve me indikacion për transfuzion autolog.
- 2.6.Përzgjedhja, kontrolli dhe menaxhimi i dhuruesve të përbërësve specifikë të gjakut përmes aferezës, duke zbatuar monitorimin e reaksioneve të padëshirueshme dhe raportimin e tyre;
- 2.7.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatëse të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
- 2.8.Hartimi dhe zbatimi i strategjive për të përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e dhurimit të gjakut përmes aferezës, përfshirë procedurat e kontrollit të cilësisë dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare;
- 2.9.Zhvillimi dhe organizimi i programeve të rregullta për edukim dhe trajnime për stafin, për të siguruar ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe përputhjen me teknologjitë dhe praktikat më të

fundit në fushën e aferezës.

3. Departamenti për Aferezë udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.

4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:

4.1. Divizioni për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë;

4.2. Divizioni për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit;

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Aferezë, është tetë (8).

Neni 14

Divizioni për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë, janë:

1.1. Planifikimi dhe organizimi për nevojat kombëtare për përbërës specifikë të gjakut, të marrë përmes aferezës, bazuar në kërkesat klinike dhe kapacitetet e furnizimit;

1.2. Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin dhe informimin e popullatës mbi rëndësinë e dhurimit të përbërësve të gjakut përmes aferezës për të siguruar një bazë të qëndrueshme të dhuruesve;

1.3. Përzgjedhja, kontrolli dhe menaxhimi i dhuruesve të përbërësve specifikë të gjakut përmes aferezës, duke zbatuar monitorimin e reaksioneve të padëshirueshme dhe raportimin e tyre;

1.4. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatës të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.5. Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të kontrollit të cilësisë për të siguruar një dhurim të sigurt dhe cilësor të përbërësve të gjakut;

1.6. Identifikimi dhe rekrutimi i dhuruesve të përshtatshëm për aferezë, duke përfshirë dhënien e informacionit të plotë mbi procesin dhe përfitimet;

1.7. Përgatitja e planit vjetor të grumbullimit të përbërësve të gjakut përmes aferezës, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2. Divizioni për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Aferezë.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Dhurim të Përbërësve të Gjakut me Aferezë, është tre (3).

Neni 15

Divizioni për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit, janë:

1.1. Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit për përzgjedhjen dhe menaxhimin e pacientëve për

transfuzione autologe dhe format tjera të dhurimit, duke siguruar përshtatjen me nevojat shëndetësore;

1.2.Zbatimi i procedurave të sigurta dhe të kontrolluara për transfuzionet autologe dhe dhurimet tjera, në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë;

1.3.Identifikimi dhe përzgjedhja e dhuruesve të përshtatshëm për transfuzion autolog dhe dhurime të tjera, në përputhje me standardet mjekësore dhe klinike;

1.4.Monitorimi dhe raportimi i reaksioneve të padëshiruara të mundshme të transfuzioneve autologe për të siguruar ndërhyrje me kohë dhe përmirësimin e proceseve;

1.5.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatës të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.6.Përgatitja e planit vjetor të transfuzionit autolog dhe format e tjera të dhurimit, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;

2.Divizioni për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Aferezë.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit, është tre (3).

Neni 16

Departamenti për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjikut

1.Misioni i Departamentit për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjikut është të planifikojë dhe koordinojë ndarjen dhe përpunimin e gjikut në nivel kombëtar, duke siguruar standardet më të larta të sigurisë dhe cilësisë, ruajtjen optimale të produkteve, mbikëqyrjen e pajisjeve dhe zhvillimin profesional të stafit.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjikut, janë:

2.1.Planifikimi dhe koordinimi strategjik i nevojave kombëtare për ndarjen e gjikut dhe përbërësve të gjikut, duke u bazuar në parashikimet e kërkesës dhe standardet e përcaktuara;

2.2.Zhvillimi dhe standardizimi i metodave për ndarjen e gjikut dhe përbërësve të tij në përputhje me udhëzimet dhe praktikatat më të mira në fushën e transfuzionit të gjikut;

2.3.Ndarja, përgatitja dhe ruajtja e produkteve intermediare dhe finale të gjikut, duke siguruar ruajtjen e tyre në kushte të përshtatshme për të garantuar efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe cilësinë;

2.4.Ndarja konvencionale gjikut për përgatitjen e përbërësve qelizorë dhe derivate të plazmës, për të siguruar produkte të gjikut që plotësojnë kërkesat specifike klinike;

2.5.Ndarja speciale e gjikut për përgatitjen e përbërësve qelizorë dhe derivateve të plazmës, për t'iu përgjigjur kërkesave të veçanta të pacientëve dhe procedurave të specializuara mjekësore;

- 2.6. Sigurimi i etiketimit të saktë, regjistrimit elektronik dhe fizik, si dhe depozitimit të produkteve të gjakut në kushte optimale për të ruajtur cilësinë dhe sigurinë e tyre;
- 2.7. Menaxhimi i pajisjeve të zinxhirit të ftohtë, përfshirë mirëmbajtjen, përdorimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e rregullt për të siguruar funksionimin e pandërprerë dhe cilësinë e produkteve të ruajtura;
- 2.8. Planifikimi strategjik i proceseve e për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së produkteve të gjakut, për të garantuar që ato përmbushin standardet më të larta të cilësisë;
- 2.9. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet dhe divizionet përkatës të institucionit, për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
- 2.10. Organizimi i edukimit të vazhdueshëm, trajnimeve dhe ngritjes profesionale të personelit, për të rritur kompetencat e stafit dhe për të mbajtur standarde të larta në të gjitha proceset e përpunimit të gjakut.
3. Departamenti për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.
4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:
- 4.1. Divizioni për Ndarje Konvencionale të Gjakut;
- 4.2. Divizionit për Ndarje Speciale të Gjakut dhe Zinxhirin e Ftohtë;
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut, është tetë (8).

Neni 17

Divizioni për Ndarje Konvencionale të Gjakut

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ndarje Konvencionale të Gjakut, janë:
- 1.1. Përgatitja dhe ndarja konvencionale e gjakut në përbërës qelizorë dhe derivate të plazmës, duke siguruar përputhshmëri me standardet e cilësisë dhe sigurisë së përbërësve të gjakut;
- 1.2. Monitorimi i vazhdueshëm dhe ruajtja e gjakut dhe përbërësve të gjakut në kushte optimale për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e përbërësve të gjakut;
- 1.3. Sigurimi që përbërësit e gjakut të ndara janë të etiketuara dhe të regjistruara saktë në sistemet elektronike dhe fizike për të shmangur çdo lloj keqinterpretimi;
- 1.4. Depozitimi dhe ruajtja e produkteve konvencionale të gjakut në kushte të përshtatshme për të siguruar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre;
- 1.5. Bashkëpunimi dhe koordinimi me njësitë tjera për të siguruar fluksin e pandërprerë të punës dhe përputhjen me kërkesat klinike;
- 1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione përkatës të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.7.Përgatitja e planit vjetor për ndarje konvencionale të gjakut në përbërës të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;

2.Divizioni për Ndarje Konvencionale të Gjakut udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Ndarje Konvencionale të Gjakut, është tre (3).

Neni 18

Divizioni për Ndarje Speciale dhe Zinxhirin e Ftoftë

1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ndarje Speciale dhe Zinxhirin e Ftoftë, janë:

1.1.Përgatitja dhe ndarja speciale në përbërës të caktuar të gjakut me cilësi të lartë, duke siguruar përputhshmëri me standardet e cilësisë dhe sigurisë së përbërësve të gjakut;

1.2.Monitorimi i vazhdueshëm dhe ruajtja e përbërësve të caktuar të gjakut në kushte optimale për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e përbërësve të gjakut;

1.3.Sigurimi që përbërësit e caktuar të gjakut të përfituar me ndarje speciale, janë të etiketuara dhe të regjistruara saktë në sistemet elektronike dhe fizike për të shmangur çdo lloj keqinterpretimi;

1.4.Depozitimi dhe ruajtja e përbërësve specialë të gjakut në kushte të përshtatshme për të siguruar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre;

1.5.Sigurimi i temperaturave të duhura për ruajtjen e gjakut dhe përbërësve të gjakut në kushte optimale nga grumbullimi, përpunimi, testimi, deponimi, shpërndarja, transporti, deri në lëshim, për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e tyre;

1.6.Monitorimi dhe evidentimi i vazhdueshëm i temperaturave në formën elektronike dhe të shkruar të përbërësve të gjakut në institucionet e autorizuara transfuzive, ekipet mobile dhe gjatë transportit;

1.7.Zhvillimi dhe integrimi i teknologjive të reja për përmirësimin dhe avancimin e proceseve të monitorimit të temperaturave gjatë përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produkteve të gjakut;

1.8.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive

1.9.Përgatitja e planit vjetor për ndarje speciale të gjakut dhe zingjirin e ftoftë, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.Divizioni për Ndarje Speciale dhe Zinxhirin e Ftoftë udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Ndarje Speciale dhe Zinxhirin e Ftoftë, është tre (3).

Neni 19

Departamenti për Transfuzionin Klinik të Gjakut

1.Misioni i Departamentit për Transfuzionin Klinik të Gjakut është të sigurojë një sistem të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për furnizimin me gjak dhe përbërësve të tij, duke garantuar cilësi dhe qasje për transfuzione të sigurta dhe efektive për nevojat shëndetësore të pacientëve;

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Transfuzionin Klinik të Gjakut, janë:

2.1.Planifikimi strategjik i nevojave për gjak dhe përbërës të gjakut për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas për institucionet shëndetësore;

2.2.Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të autorizuar transfuzive dhe institucioneve shëndetësore të cilat përdorin gjak ose përbërës të gjakut;

2.3.Organizimi dhe menaxhimi i furnizimit me gjak dhe përbërës të tij për institucionet shëndetësore, duke mbajtur stok të sigurt dhe efikas për nevoja emergjente dhe rutinë;

2.4.Promovimi i përdorimit racional të gjakut dhe përbërësve të tij përmes zbatimit të protokolleve klinike, trajnimit të personelit mjekësor dhe sensibilizimit të institucioneve shëndetësore për menaxhimin efektiv dhe të sigurt të rezervave të gjakut;

2.5.Testimi i përputhshmërisë mes dhuruesve të gjakut dhe pacientit për të siguruar transfuzione të sigurta dhe efikase;

2.6.Menaxhimi i reaksioneve të padëshiruara post-transfuzive përmes ritestimit, analizimit të rasteve të raportuar nga institucionet shëndetësore;

2.7.Zbatimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të integruar të hemovigjilencës për raportimin e sigurt të transfuzioneve të gjakut;

2.8.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

2.9.Planifikimi strategjik i proceseve për rritjen e sigurt dhe cilësisë për përdorim klinik të gjakut dhe përbërësve të gjakut;

2.10.Përgatitja e planit vjetor për transfuzionin klinik të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.11.Organizimi i edukimit të vazhdueshëm, trajnimeve dhe ngritjes profesionale të personelit, për të rritur kompetencat e stafit dhe për të mbajtur standarde të larta në të gjitha proceset e transfuzionin klinik të gjakut.

3.Departamenti për Transfuzionin Klinik të Gjakut, udhëhiqet nga Drejtori, i cili raporton Drejtorit të Ekzekutiv.

4.Departamenti për Transfuzionin Klinik të Gjakut përbëhet nga këto divizione:

4.1.Divizioni për Interaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut;

4.2.Divizioni për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut;

5.Numri i të punësuarve në Departamentin për Transfuzionin Klinik të Gjakut, është dymbëdhjetë (12).

Neni 20

Divizioni për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut

1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut, janë:

1.1.Planifikimi, hartimi dhe zbatimi i protokolleve për përdorimin klinik të gjakut dhe përbërësve të tij në përputhje me nevojat e institucioneve shëndetësore;

1.2.Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës ndërmjet institucioneve të autorizuar transfuzive dhe institucioneve shëndetësore për të siguruar përdorim racional të gjakut dhe përbërësve të tij;

1.3.Mbështetja teknike dhe profesionale në lidhje me testimin e përputhshmërisë dhe transfuzionet klinike;

1.4.Analizimi dhe raportimi i rasteve të reaksioneve të padëshiruara post-transfuzive;

1.5.Zgjerimi dhe zhvillimi procedurave standarde të operimit për interreaksione dhe përdorim klinik të gjakut;

1.6.Hartimi i strategjive për të reduktuar përdorimin e panevojshëm të gjakut dhe përbërësve të tij përmes promovimit të alternativeve të trajtimit;

1.7.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës;

1.8.Përgatitja e planit vjetor për interreaksione dhe përdorim klinik të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.Divizioni për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Transfuzionin Klinik të Gjakut.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut është shtatë (7).

Neni 21

Divizioni për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut

1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut janë:

1.1.Organizimi dhe menaxhimi i proceseve të shpërndarjes së gjakut dhe përbërësve të tij për institucionet shëndetësore;

1.2.Sigurimi i stokut të sigurt dhe të qëndrueshëm të produkteve të gjakut për nevoja emergjente dhe rutinë si dhe menaxhimi i krizave dhe emergjencave për gjak dhe përbërës të gjakut;

- 1.3.Koordinimi me institucionet e autorizuar transfuzive dhe institucionet shëndetësore për të planifikuar dhe ekzekutuar shpërndarjen efikase të gjakut dhe përbërësve të tij;
 - 1.4.Monitorimi dhe përditësimi i të dhënave për furnizimin dhe shpërndarjen e gjakut për të siguruar efikasitet dhe transparencë;
 - 1.5.Zbatimi i protokolleve për ruajtjen, transportimin dhe shpërndarjen e sigurt të gjakut dhe përbërësve të tij;
 - 1.6.Hartimi i raporteve periodike mbi shpërndarjen e produkteve të gjakut dhe analizimi i të dhënave për përmirësim të proceseve;
 - 1.7.Integrimi i teknologjive të reja për të optimizuar proceset logjistike të shpërndarjes së gjakut dhe përbërësve të tij;
 - 1.8.Zbatimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të integruar të hemovigjilencës për monitorimin dhe raportimin e sigurisë së transfuzioneve të gjakut dhe mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi incidentet dhe reaksionet e padëshiruara të lidhura me transfuzionet e gjakut;
 - 1.9.Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore për raportimin e rasteve të reaksioneve transfuzive dhe menaxhimin e tyre;
 - 1.10.Hartimi i procedurave standarde të operimit për hemovigjencë;
 - 1.11.Zhvillimi i politikave për menaxhimin e rasteve të padëshiruara dhe promovimi i kulturës së sigurisë dhe përgjegjësisë në të gjitha nivelet e menaxhimit të transfuzioneve të gjakut;
 - 1.12.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 1.13.Përgatitja e planit vjetor për hemovigjilencë dhe shpërndarje të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.
- 2.Divizioni për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Transfuzionin Klinik të Gjakut.
- 3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Hemovigjilencë dhe Shpërndarje të Gjakut është tre (3).

Neni 22

Departamenti për Imunohematologji

- 1.Misioni i Departamentit për Imunohematologji është të sigurojë cilësinë, sigurinë dhe avancimin e testeve dhe shërbimeve imunohematologjike përmes zhvillimit dhe zbatimit të proceseve të standardizuara, përdorimit të teknologjive inovative në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Imunohematologji, janë:
 - 2.1.Zhvillimi dhe zbatimi i planeve strategjike dhe procedurave operacionale për proceset imunohematologjike, duke siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe

rregulloret kombëtare shëndetësore;

2.2. Bashkëpunimi dhe koordinimi me njësitë tjera organizative, institucionet shëndetësore publike dhe private, si dhe organizatat ndërkombëtare për shkëmbim të praktikave më të mira dhe avancimin e teknologjive të reja në Imunohematologji;

2.3. Testimi imunohematologjik i dhuruesve të gjakut, përfshirë raste atipike, skringun e antitropave irregular dhe testimin molekular të grupeve të gjakut për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të gjakut;

2.4. Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i indikatorëve të performancës laboratorike dhe zbatimi i masave korrigjuese për rritjen e efikasitetit;

2.5. Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të automatizimit dhe digjitalizimit në proceset e testimit për të rritur efikasitetin dhe për të minimizuar gabimet njerëzore;

2.6. Zhvillimi i bashkëpunimit me departamente të tjera dhe institucione kërkimore për realizimin e studimeve shkencore dhe avancimin e njohurive në fushën e imunohematologjisë;

2.7. Planifikimi dhe zhvillimi i metodave dhe proceseve për përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së testeve imunohematologjike në përputhje me standardet laboratorike dhe rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë;

2.8. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarrëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

2.9. Organizimi i edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve për personelin, duke përfshirë kurse të avancuara, seminare dhe programe ndërkombëtare për ngritjen profesionale;

3. Departamenti për Imunohematologji, udhëhiqet nga Drejtori, i cili raporton Drejtorit të Ekzekutiv.

4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:

4.1. Divizioni për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut;

4.2. Divizioni për Divizioni për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Imunohematologji, është tetë (8).

Neni 23

Divizioni për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut, janë:

1.1. Realizimi i testeve imunohematologjike për dhuruesit e gjakut, duke përfshirë përcaktimin e grupeve të gjakut dhe skringun e antitropave irregular;

1.2. Përdorimi i sistemeve të automatizuara përfshirë digjitalizimin e proceseve për të rritur

efikasitetin dhe saktësinë në testimet e dhuruesve të gjakut;

1.3. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.4. Planifikimi i proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë të testimit imunohematologjik;

1.5. Përgatitja e planit vjetor për testime imunohematologjike të dhuruesve të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2. Divizioni për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Imunohematologji.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut është tre (3).

Neni 24

Divizioni për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike, janë:

1.1. Realizimi i testimeve molekulare për përcaktimin e grupeve të gjakut dhe fenotipizimit/gjenotipizimit të dhuruesve dhe pacientëve;

1.2. Sigurimi i përshtatshmërisë së gjakut për raste të veçanta, duke minimizuar rrezikun e reaksioneve transfuzive;

1.3. Zhvillimi dhe zbatimi i protokollove dhe metodave molekulare për të rritur saktësinë dhe efikasitetin në identifikimin e grupeve të gjakut;

1.4. Bashkëpunimi me institucione kërkimore për avancimin e njohurive dhe praktikave në fushën e testimeve molekulare të gjakut;

1.5. Automatizimi dhe digjitalizimi i analizave molekulare për të reduktuar gabimet dhe për të përmirësuar shpejtësinë e testimeve.

1.6. Realizimi i testimeve për raste problematike dhe komplekse, duke përfshirë diagnostikimin dhe zgjidhjen e problemeve imunohematologjike;

1.7. Kryerja e analizave për identifikimin e antitropave të rrallë dhe përputhshmërinë transfuzive për pacientët me nevojë të veçanta;

1.8. Zhvillimi dhe zbatimi i metodave dhe teknikave të reja për trajtimin dhe analizimin e rasteve problematike;

1.9. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.10. Përgatitja e planit vjetor për testime imunohematologjike të dhuruesve të gjakut, si dhe

dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.Divizioni për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Imunohematologji.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike është tre (3).

Neni 25

Departamenti për Sëmundjet e Transmetueshme

1.Misioni i Departamentit për Sëmundjet e Transmetueshme është të sigurojë një proces të sigurt, të saktë dhe efikas të testimit serologjik, menaxhimit dhe raportimit të sëmundjeve të transmetueshme rasteve reaktive, duke garantuar cilësinë e dozave të gjakut, mbrojtjen e shëndetit publik dhe përputhshmërinë me standardet më të larta profesionale dhe etike.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Sëmundjet e Transmetueshme, janë:

2.1.Testimi serologjik i të gjitha dozave të dhuruara të gjakut për identifikimin e agentëve infektivë të transmetueshëm përmes gjakut, duke siguruar cilësinë dhe sigurinë e tyre;

2.2.Planifikimi dhe ekzekutimi i procesit të ri-testimit për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e dozave të testuar, duke përdorur teknologji të avancuar dhe metodologji bashkëkohore;

2.3.Sigurimi i largimit të dozave reaktive nga përdorimi, organizimi i karantinimit të tyre dhe dokumentimi i procesit;

2.4.Njoftimi i dhuruesve të gjakut për rezultatet reaktive në mënyrë etike dhe profesionale, duke ofruar këshillime dhe udhëzime për hapat e ardhshëm shëndetësorë;

2.5.Mbajtja e regjistrave të detajuar për rastet reaktive, përgatitja e raporteve përkatëse dhe dërgimi i tyre tek autoritetet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.6.Koordinimi i vazhdueshëm dhe efektiv me Qendrat e Transfuzionit të Gjakut rajonale për ndarjen e informacionit dhe bashkërendimin e aktiviteteve për përmirësimin e proceseve;

2.7.Sigurimi i zbatimit të praktikave të mira laboratorike përfshirë kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e vazhdueshëm të rezultateve laboratorike, për të garantuar sigurinë dhe besueshmërinë e testeve;

2.8.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

2.9.Organizimi i edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve për personelin, duke përfshirë kurse të avancuara, seminare dhe programe ndërkombëtare për ngritjen profesionale.

3.Departamenti për Sëmundjet e Transmetueshme, udhëhiqet nga Drejtori, i cili raporton Drejtorit Ekzekutiv.

4.Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:

- 4.1.Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut;
- 4.2.Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve;
- 5.Numri i të punësuarve në Departamentin për Sëmundjet e Transmetueshme, është tetë (8).

Neni 26
Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme
të Dhuruesve të Gjakut

1.Detyrat dhe Përgjegjësitë për Divizionin për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut, janë:

- 1.1.Kryerja e testeve serologjike për identifikimin e agjentëve infektivë të transmetueshëm përmes gjakut, duke siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të gjakut;
 - 1.2.Vërtetimi dhe konfirmimi i rezultateve të testeve/skriningut serologjike, duke përfshirë interpretimin dhe dokumentimin e saktë të rezultateve;
 - 1.3.Planifikimi dhe realizimi i procesit të ritestimit të dozave të gjakut të dhuruar për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së testeve, duke përdorur teknologji të avancuar;
 - 1.4.Organizimi dhe dokumentimi i procesit të largimit të dozave të gjakut me rezultate reaktive nga përdorimi, përfshirë karantinimin e tyre;
 - 1.5.Informimi i dhuruesve të gjakut për rezultatet reaktive, duke ofruar këshillim profesional dhe udhëzime për hapat e ardhshëm shëndetësorë;
 - 1.6.Mbajtja e regjistrave të detajuar për rastet reaktive dhe përgatitja e raporteve periodike për rezultatet si dhe dërgimi i tyre te autoritetet përkatëse;
 - 1.7.Koordinimi i vazhdueshëm me qendrat e transfuzionit të gjakut për ndarjen e informacionit dhe përmirësimin e proceseve të punës;
 - 1.8.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 1.9.Përgatitja e planit vjetor për testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të dhuruesve të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;
- 2.Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Sëmundjet e Transmetueshme.
- 3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut është tre (3).

Neni 27

Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve, janë:

1.1. Kryerja e testeve serologjike të pacientëve për identifikimin e agjentëve infektivë që mund të transmetohen përmes gjakut ose procedurave të tjera mjekësore ;

1.2. Vërtetimi dhe konfirmimi i rezultateve të testeve serologjike, duke ofruar interpretim të saktë dhe dokumentim për përdorim klinik dhe raportim;

1.3. Monitorimi i cilësisë dhe organizimi i riteve kur është e nevojshme për garantimin e saktësisë dhe saktësisë së rezultateve laboratorike;

1.4. Informimi i institucioneve shëndetësore për rezultatet reaktive të pacientëve;

1.5. Mbajtja e regjistrave të veçantë dhe përgatitja e raporteve mbi rezultatet e testeve të pacientëve;

1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarrëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.7. Përgatitja e planit vjetor për testimin e sëmundjeve të transmetueshme të pacientëve, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

1.8. Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Sëmundjet e Transmetueshme.

1.9. Numri i të punësuarve në Divizion për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve është tre (3).

Neni 28

Departamenti për Testime Prenatale

1. Misioni i Departamentit për Testime Prenatale është të ofrojë diagnostikim të avancuar dhe të besueshëm në testimet prenatale dhe imunohematologjike, duke mbrojtur shëndetin e nënave dhe foshnjave.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Testime Prenatale, janë:

2.1. Kryerja e testeve prenatale të specializuara për shtatzënat dhe pacientët klinikë, duke siguruar diagnostikim të saktë dhe të besueshëm;

2.2. Realizimi i testeve imunohematologjike për shtatzënat dhe bashkëshortët, duke përfshirë identifikimin e grupeve të gjakut dhe faktorëve Rh për parandalimin e inkompatibiliteteve të mundshme;

2.3. Kryerja e testeve të detajuara për të porsalindurit, duke përfshirë skringun neonatal;

- 2.4. Testimi i pacientëve klinik dhe rasteve ambulatorë, duke përfshirë bashkëpunimin me mjekët klinikë për interpretimin e rezultateve dhe përcaktimin e trajtimeve të nevojshme;
 - 2.5. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 2.6. Planifikimi strategjik i proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së testimeve imunohematologjike prenatale dhe të pacientëve;
 - 2.7. Organizimi i programeve të trajnimit dhe edukimit për personelin, me fokus në ngritjen e kompetencave profesionale, përditësimin me zhvillimet shkencore dhe zbatimin e standardeve të reja.
3. Departamenti për Testime Prenatale, udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.
 4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:
 - 4.1. Divizioni për Testime Prenatale;
 - 4.2. Divizioni për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik.
 5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Testime Prenatale, është tetë (8).

Neni 29

Divizioni për Testime Prenatale

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testime Prenatale janë:
 - 1.1. Kryerja e testimeve imunohematologjike diagnostike dhe laboratorike për shtatzënat dhe fëmijët e porsalindur;
 - 1.2. Monitorimi i shtatzënave për inkompatibilitete imunohematologjike, përfshirë përcaktimin e grupit të gjakut dhe faktorit Rh, dhe rekomandimin e masave parandaluese për rastet me rrezik;
 - 1.3. Bashkëpunimi dhe koordinimi efektiv me njësitë tjera dhe institucionet shëndetësore, për të siguruar një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse ndaj testimeve prenatale;
 - 1.4. Sigurimi i zbatimit të praktikës së mirë laboratorike përmes planifikimit të proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së testeve laboratorike;
 - 1.5. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 1.6. Përgatitja e planit vjetor për testime prenatale, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.
2. Divizioni për Testime Prenatale, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Testime Prenatale.

3.Numri i të punësuarve në Divizioni për Testime Prenatale, është tre (3).

Neni 30 **Divizioni për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik**

1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik, janë:

- 1.1.Realizimi i testeve imunohematologjike për pacientët klinik dhe rasteve ambulatorë;
- 1.2.Sigurimi i zbatimit të praktikës së mirë laboratorike përmes planifikimit të proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së testeve laboratorike;
- 1.3.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarrëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
- 1.4.Menaxhimi i të dhënave të pacientëve dhe mbajtja e dokumentacionit të përditësuar për të siguruar gjurmueshmëri dhe raportim të saktë;
- 1.5.Përgatitja e planit vjetor për teste imunohematologjike për pacientët klinik, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2.Divizioni për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Testime Prenatale.

3.Numri i të punësuarve në Divizionin për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik, është tre (3).

Neni 31 **Departamenti për Hemostazë**

1.Misioni i Departamentit për Hemostazë është të sigurojë diagnostikim dhe trajtim të avancuar të çrregullimeve të hemostazës dhe trombozës, të garantojë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve, si dhe të promovojë zhvillimin profesional dhe përdorimin e praktikave moderne në përputhje me standardet më të larta mjekësore.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Hemostazë, janë:

- 2.1.Planifikimi dhe mbikëqyrja e testeve për çrregullimet e hemostazës dhe trombozës, duke përfshirë pacientët klinikë dhe ambulatorë, për të siguruar diagnostikim të saktë dhe të shpejtë;
- 2.2.Organizimi dhe mbikëqyrja e procesit të punës për diagnostikimin e koagulopative të lindura dhe të fituara, si dhe trajtimi i patologjive specifike hematologjike në përputhje me protokollat e avancuara mjekësore;
- 2.3.Hartimi dhe zbatimi i procedurave operative standarde për të optimizuar procesin e punës dhe testimet lidhur me çrregullimet e hemostazës dhe trombozës te pacientët klinikë dhe ambulatorë;
- 2.4.Testimi dhe diagnostikimi i avancuar i koagulopative të lindura dhe të fituara, si dhe patologjive të tjera hematologjike specifike, përmes teknologjive moderne laboratorike dhe analizave të specializuara;

- 2.5. Zhvillimi dhe aplikimi i testimeve gjenetike për çrregullimet e hemostazës dhe koagulopative, duke përfshirë përdorimin e metodave molekulare për pacientët klinikë dhe ambulatorë;
 - 2.6. Monitorimi, përshkrimi dhe përshtatja e terapive antikoagulante për pacientëve klinikë dhe ambulatorë, duke ndjekur protokollet klinike dhe individualizimin e trajtimeve bazuar në gjendjen e pacientëve;
 - 2.7. Testimi i produkteve të gjakut dhe kontrolli i cilësisë së derivateve të plazmës, duke siguruar përputhjen me standardet e cilësisë dhe sigurisë;
 - 2.8. Planifikimi strategjik dhe zhvillimi i protokolleve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së produkteve të gjakut dhe derivateve të tij;
 - 2.9. Planifikimi strategjik i proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së testeve të hemostazës;
 - 2.10. Organizimi i programeve të edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve të specializuara për ngritjen e kompetencave profesionale të stafit, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe standardet më të fundit në fushën e hemostazës.
3. Departamenti për Hemostazë, udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.
4. Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:
- 4.1. Divizioni për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative;
 - 4.2. Divizioni për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Hemostazë, është tetë (8);

Neni 32

Divizioni për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative, janë:
- 1.1. Planifikimi dhe realizimi i testimeve diagnostike për çrregullimet e hemostazës dhe trombozës për pacientët klinikë dhe ambulatorë, duke siguruar diagnostikim të saktë dhe të shpejtë;
 - 1.2. Zbatimi i procedurave të standardizuara për identifikimin dhe trajtimin e koagulopative dhe çrregullimeve të tjera të hemostazës në përputhje me protokollet mjekësore;
 - 1.3. Hartimi, zbatimi dhe rishikimi i procedurave operative standarde për të përmirësuar procesin e testimeve dhe diagnostikimit të çrregullimeve të hemostazës;
 - 1.4. Ndjekja dhe përshtatja e terapive për pacientët klinikë dhe ambulatorë, duke u bazuar në rezultatet laboratorike dhe protokollet individuale të trajtimit;

1.5. Avancimi i teknologjive laboratorike për diagnostikimin e çrregullimeve të hemostazës;

1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.7. Përgatitja e planit vjetor për testimin e çrregullimeve të hemostazës dhe koagulopative, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2. Divizioni për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Hemostazë.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative, është tre (3).

Neni 33

Divizioni për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut, janë:

1.1. Realizimi i testimeve për të siguruar që produktet e ngrira të gjakut dhe derivatet e plazmës përmbushin standardet e sigurisë dhe cilësisë;

1.2. Zhvillimi i udhëzimeve dhe procedurave standarde operative për testimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të gjakut të ngrira.

1.3. Mbajtja e regjistrave të veçantë dhe përgatitja e raporteve mbi rezultatet e testimeve të produkteve të ngrira dhe derivateve të plazmës;

1.4. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.5. Përgatitja e planit vjetor për testimin e produkteve të ngrira të gjakut, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2. Divizioni për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Hemostazë.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut, është tre (3).

Neni 34

Departamenti për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut

1. Misioni i Departamentit për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut është të sigurojë cilësinë dhe sigurinë maksimale të produkteve të gjakut përmes zbatimit të standardeve dhe praktikave më të mira prodhuese, laboratorike dhe klinike, monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut, janë:

- 2.1.Zbatimi i masave, standardeve dhe specifikave teknike në përputhje me rekomandimet e Këshillit Evropian, Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe praktikave të mira prodhuese, laboratorike dhe klinike, me qëllim të sigurimit të cilësisë ;
 - 2.2.Hartimi, rishikimi dhe propozimi për përmirësimin e udhëzimeve dhe procedurave standarde operative, për proceset e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve të gjakut;
 - 2.3.Mbikëqyrja dhe realizimi i kontrolleve të cilësisë dhe sigurisë së produkteve të gjakut, duke përfshirë analizat periodike të tyre;
 - 2.4.Zhvillimi dhe realizimi i kontrolleve mikrobiologjike, biofizike, kimike dhe molekulare, duke përfshirë testimin NAT dhe teknologjitë e tjera të avancuara për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e përbërësve të gjakut;
 - 2.5.Zhvillimi i bashkëpunimit aktiv me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata profesionale dhe individë të specializuar në fushën e kontrollit të cilësisë;
 - 2.6.Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 2.7.Planifikimi strategjik i proceseve për rritjen e sigurisë dhe cilësisë së gjakut dhe produkteve të gjakut;
 - 2.8.Organizimi i programeve për edukimin, trajnimin dhe ngritjen profesionale të personelit, duke siguruar aftësimin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe teknologjitë e reja;
- 3.Departamenti për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut, udhëhiqet nga Drejtori, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv.
- 4.Në kuadër të këtij Departamenti, bëjnë pjesë:
- 4.1.Divizioni për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë;
 - 4.2.Divizioni për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT.
- 5.Numri i të punësuarve në Departamentin për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut, është tetë (8);

Neni 35 **Divizioni për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë**

- 1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë, janë:
 - 1.1.Zbatimi i masave, standardeve dhe specifikave teknike në përputhje me rekomandimet e Këshillit Evropian, Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe praktikave të mira prodhuese, laboratorike dhe klinike;
 - 1.2.Hartimi, rishikimi dhe përmirësimi i udhëzimeve dhe procedurave standarde operative për proceset e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve të gjakut;

- 1.3. Mbikëqyrja dhe realizimi i kontrolleve të cilësisë dhe sigurisë së produkteve të gjakut në mënyrë periodike.
 - 1.4. Mbledhja, analizimi dhe interpretimi i të dhënave për të identifikuar tendencat dhe për të sugjeruar përmirësime në cilësinë dhe sigurinë e produkteve.
 - 1.5. Bashkëpunimi me institucione si dhe ekspertë individualë në fushën e kontrollit të cilësisë, për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të ndjekur zhvillimet e fundit shkencore;
 - 1.6. Zhvillimi dhe realizimi i kontrolleve mikrobiologjike për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të gjakut;
 - 1.7. Sigurimi që të gjitha proceset e kontrollit mikrobiologjik përputhen me standardet ndërkombëtare dhe udhëzimet kombëtare;
 - 1.8. Monitorimi i cilësisë së produkteve të gjakut përmes analizave të rregullta mikrobiologjike;
 - 1.9. Dokumentimi dhe raportimi i rezultateve të kontrolleve mikrobiologjike në bazë të analizave të kryera dhe sugjerimi i masave korrigjuese kur është e nevojshme;
 - 1.10. Kryerja e analizave mikrobiologjike për identifikimin e mikrobeve patogjene dhe minimizimin e rreziqeve;
 - 1.11. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
 - 1.12. Përgatitja e planit vjetor për kontroll të cilësisë dhe mikrobiologjisë, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.
2. Divizioni për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë, është tre (3)

Neni 36

Divizioni për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT, janë:
- 1.1. Realizimi i testimeve molekulare (NAT) për identifikimin dhe monitorimin e sëmundjeve infektive të transmetueshme përmes gjakut;
 - 1.2. Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së procesit të testimeve molekulare për të garantuar rezultate të sakta dhe të besueshme;
 - 1.3. Aplikimi i teknologjive moderne molekulare për diagnostikimin dhe zbulimin e sëmundjeve infektive, duke përfshirë teknologjinë PCR dhe testet e tjera të avancuara;

1.4. Analizimi dhe interpretimi i rezultateve të testimeve molekulare për të ndihmuar në vendimmarrjen mbi përdorimin e produkteve të gjakut;

1.5. Njoftimi i dhuruesve të gjakut për rezultatet reaktive të testimeve molekulare në mënyrë etike dhe profesionale, duke ofruar këshillime dhe udhëzime për hapat e ardhshëm shëndetësorë;

1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;

1.7. Përgatitja e planit vjetor për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta.

2. Divizioni për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT, është tre (3).

Neni 37 **Departamenti i infermierisë**

1. Misioni i Departamentit të Infermierisë është të sigurojë një organizim efikas dhe të sigurt të punës në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive përmes menaxhimit të stafit të kryeinfermierëve, infermierëve dhe teknikëve laborant në QKKTGj përfshirë Qendrat e Transfuzionit të Gjakut.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të infermierisë janë:

2.1. Menaxhimi dhe koordinimi i infermierëve, teknikëve dhe kryeinfermierëve të departamenteve të QKKTGj-së dhe QTGj-ve rajonale;

2.2. Krijimi dhe kontrolli i zbatimit të planit të rishpërndarjes së stafit në përputhje me nevojat e QKKTGj-së;

2.3. Sigurimi i përgatitjes profesionale të stafit në funksion të detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara;

2.4. Bashkëpunimi me drejtuesit e njësive organizative dhe drejtorin në alokimin e stafit të nevojshëm sipas kërkesave dhe nevojave të njësive dhe procesit të punës;

2.5. Përmirësimi i organizimit të punës, koordinimi, zhvillimi, prezantimi dhe zbatimi i standardeve dhe normave të punës;

2.6. Sigurimi i shërbimeve të punës në përputhje me një kod të praktikës profesionale që është në përputhje me rolin e profesionistëve shëndetësorë;

2.7. Bashkëpunimi dhe koordinimi me personat përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave patologjike dhe medicinale në QKKTGj dhe QTGj rajonale;

- 2.8. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamentet tjera në institucionin e autorizuar transfuziv në të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
- 2.9. Organizimi i programeve për edukimin, trajnimin dhe ngritjen profesionale të personelit, duke siguruar aftësimin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe teknologjitë e reja.
3. Departamenti i infermierisë, udhëhiqet nga Drejtori i cili, i raporton Drejtorit të Ekzekutiv.
4. Departamenti për infermieri përbëhet nga këto Divizione:
- 4.1. Divizioni për Infermieri në QKKTGj;
- 4.2. Divizioni për Infermieri për Qendrat e Transfuzionit të Gjakut Rajonale;
5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Infermierisë, është tetë (8).

Neni 38
Divizioni për Infermieri në QKKTGj

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Infermieri në QKKTGj, janë:
- 1.1. Sigurimi i zbatimit të procedurave standarde të punës për procesin e dhurimit të gjakut, përpunimit, testimit dhe ruajtjes së gjakut dhe produkteve të tij;
- 1.2. Sigurimi që stafi është i informuar për praktikën e reja dhe zhvillimet në fushën e transfuzionit të gjakut;
- 1.3. Sigurimi i disponueshmërisë të furnizimeve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e aktivitetet në terren;
- 1.4. Sigurimi dhe zbatimi i udhëzimeve për të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive;
- 1.5. Menaxhimi i mbeturinave patologjike dhe medicinale në QKKTGj Prishtinë;
- 1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të institucionit të autorizuar transfuziv për mbarëvajtjen e punës;
- 1.7. Përgatitja e planit vjetor për punën, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;
2. Divizioni për Infermieri në QKKTGj, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Infermieri.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Infermieri në QKKTGj, është tre (3).

Neni 39
Divizioni për Infermieri në QTGj

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Infermieri në QTGj, janë:

- 1.1. Sigurimi për zbatimin e procedurave standarde të punës për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut dhe produkteve të tij në QTGj rajonale;
- 1.2. Sigurimi që stafi është i informuar për praktikën e reja dhe zhvillimet në fushën e transfuzionit të gjakut.
- 1.3. Sigurimi i disponueshmërisë të furnizimeve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e përditshëm të Qendrës të Transfuzionit të Gjakut rajonale;
- 1.4. Sigurimi dhe zbatimi i udhëzimeve për të gjitha hallkat e veprimtarisë transfuzive.
- 1.5. Menaxhimi i mbeturinave patologjike dhe medicinale në QTGj rajonale;
- 1.6. Bashkëpunimi dhe koordinimi me departamente dhe divizione të QKKTGj-së dhe QTGj rajonale për mbarëvajtjen e punës;
- 1.7. Përgatitja e planit vjetor për punën, si dhe dokumentimi, azhurnimi dhe raportimi i zbatimit të tij në baza të rregullta;
4. Divizioni për Infermieri në QTGj, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit të Departamentit për Infermieri.
5. Numri i të punësuarve në Divizionin për Infermieri në QTGj, është tre (3).

Neni 40

Qendrat e Transfuzionit të Gjakut

1. Misioni i Qendrës të Transfuzionit (në tekstin në vazhdim, QTGJ) është ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe cilësore transfuzive, duke grumbulluar, përpunuar dhe shpërndarë gjak dhe përbërës të tij, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe promovimi i dhurimit vullnetar të gjakut, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit publik përmes bashkëpunimit dhe zhvillimit profesional.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës të Transfuzionit të Gjakut, janë:
 - 2.1. Ofrimi i shërbimeve transfuzive brenda rajonit/komunës që e mbulon me shërbim përfshirë mbështetjen e institucioneve shëndetësore me produkte të gjakut dhe përbërës të tij;
 - 2.2. Planifikimi, motivimi, vetëdijësimi dhe këshillimi i popullatës për dhurimin vullnetar të gjakut, përfshirë rekrutimin dhe ruajtjen e dhuruesve të rinj dhe ekzistues;
 - 2.3. Organizimi i proceseve për grumbullimin, përzgjedhjen, kontrollin dhe monitorimin e dhuruesve të gjakut, në përputhje me standardet e sigurisë dhe protokollet mjekësore;
 - 2.4. Përpunimi, ndarja dhe menaxhimi i produkteve të gjakut për përdorim klinik, duke përfshirë monitorimin e cilësisë dhe zbatimin e teknologjive të avancuara të përpunimit;
 - 2.5. Organizimi dhe mbikëqyrja e zinxhirit të ftohtë gjatë ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së gjakut dhe përbërësve të tij për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve transfuzive;

- 2.6.Realizimi i testeve imunohematologjike për dhuruesit e gjakut dhe pacientët si dhe testet prenatale, për të identifikuar nevojat për trajtim të pacientëve spitalorë dhe ambulatorë;
- 2.7.Kryerja e skringut të testeve të hemostazës, monitorimi dhe përshkrimi i terapisë antikoagulante për pacientët spitalorë dhe ambulatorë;
- 2.8.Planifikimi dhe zbatimi i proceseve të përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë në të gjitha aktivitetet transfuzive në QTGj rajonale;
- 2.9.Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet shëndetësore dhe qendrat e autorizuara transfuzive për sigurimin, përdorimin dhe menaxhimin efikas të përbërësve të gjakut;
- 2.10.Organizimi i programeve të edukimit, trajnimeve dhe ngritjes profesionale për personelin e qendrës, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e praktikave më të mira.
- 3.Qendrat e Transfuzionit të Gjakut, janë degë lokale (njësi përbërëse) e QKKTGj-së, të organizuar në nivel rajonal, në:
- 3.1.QTGj – Prizren, e cila është përgjegjëse për komunat, Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë. Numri i të punësuarve është njëmbëdhjetë (11);
- 3.2.QTGj – Pejë, e cila është përgjegjëse për komunat, Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik. Numri i të punësuarve është dymbëdhjetë (12);
- 3.3.QTGj – Mitrovicë, e cila është përgjegjëse për komunat, Mitrovicë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Numri i të punësuarve është dhjetë (10);
- 3.4.QTGj - Ferizaj, e cila është përgjegjëse për komunat, Ferizaj - Kaçanik, Shtime, Shtërpçë, Hani i Elezit. Numri i të punësuarve është tetë (8);
- 3.5.QTGj – Gjilan, e cila është përgjegjëse për komunat Gjilan, Viti, Kamenicë, Kllokot, Ranilluk, Partesh dhe Novobërdë. Numri i të punësuarve është nëntë (9);
- 3.6.QTGj - Gjakovë, e cila është përgjegjëse për komunat, Gjakovë, Rahovec dhe Malishevë. Numri i të punësuarve është dymbëdhjetë (12);
- 3.7.QTGj - Vushtrri, e cila është përgjegjëse për komunat, Vushtrri. Numri i të punësuarve është katër (4).
- 4.QTGJ udhëhiqet nga Drejtori i cili e organizon dhe e drejton punën e QTGJ-së dhe i përgjigjet Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGj-së.

Neni 41

Divizioni për Shërbime të Përbashkëta

1.Misioni i Divizionit për Shërbime të Përbashkëta është të sigurojë mbështetje gjithëpërfshirëse administrative, logjistike dhe teknologjike për funksionimin efikas të QKKTGj-së dhe qendrave rajonale, duke ofruar shërbime për mirëmbajtjen e objekteve dhe aseteve, menaxhimin e dokumentacionit, arkivit dhe depos, zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës së teknologjisë informative, si dhe administrimin e furnizimeve dhe automjeteve.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime të Përbashkëta, janë:

- 2.1.Ofrimi i shërbimeve administrative, mbështetëse dhe logjistike për organizimin e proceseve operative dhe sigurinë që funksionimi i QKKTGj-së të realizohet në mënyrë efikase dhe në përputhje me procedurat ligjore;
- 2.2.Mbështetja në formulimin dhe zbatimin e formularëve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve nga QKKTGj si dhe bashkëpunimi për përmirësimin e tyre;
- 2.3.Mbikëqyrja e mirëmbajtjes, riparimit dhe shfrytëzimit të objekteve, dhe aseteve të QKKTGj-së, përfshirë sigurimin që objektet dhe asetet të mirëmbahen sipas procedurave të përcaktuara;
- 2.4.Zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së teknologjisë informative përfshirë mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike, rrjeteve, aplikacioneve softuerike dhe masave të sigurisë kibernetike;
- 2.5.Zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së internetit të QKKTGj-së, si dhe aplikacioneve për qytetarët që të kenë qasje në shërbime dhe të marrin informacion;
- 2.6.Menaxhimi dhe organizimi i dokumentacionit të arkivit duke siguruar ruajtjen, përpunimin dhe qasjen e duhur të dokumenteve sipas standardeve ligjore;
- 2.7.Digjitalizimi dhe mirëmbajtja e dokumenteve arkivore, duke lehtësuar qasjen elektronike dhe sigurinë afatgjatë të dokumenteve;
- 2.8.Menaxhimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, përfshirë planifikimin e mirëmbajtjes, përcjelljen e shpenzimeve të karburantit dhe mbikëqyrjen e përdorimit të automjeteve;
- 2.9.Menaxhimi i depos dhe furnizimi me materiale, inventar dhe siguri i pajisjeve të nevojshme për QKKTGj-në;
- 2.10.Siguri i furnizimeve me inventar, pajise dhe materialeve shpenzuese si dhe shpërndarjes së tyre, duke planifikuar dhe koordinuar shpërndarjen për të siguruar dorëzimin e tyre në kohën e duhur;

3.Divizioni për Shërbime të Përbashkëta udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGJ-së.

4.Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime të Përbashkëta është njëmbëdhjetë (11).

Neni 42

Divizioni për Burime Njerëzore

1.Misioni i Divizionit për Burime Njerëzore është menaxhimi i proceseve për burimet njerëzore në mënyrë efikase në QKKTGj dhe njësitë përbërëse, përfshirë rekrutimin, ngritjen e kapaciteteve, vlerësimin e performancës dhe kompensimin për t'u siguruar që të punësuarit mund të kontribuojnë në mënyrë efektive.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Burime Njerëzore, janë:

2.1.Zhvillimi i përshkrimeve të punës dhe specifikimeve për vendet e lira të punës, publikimi i konkurseve, pranimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve dhe përgatitja e listës së ngushtë të kandidatëve;

2.2.Mbështetja e Komisioneve në organizimin e testit dhe intervistave me kandidatët në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe udhëheqja e procesit të emërimit të kandidatëve të përzgjedhur nga Komisionet;

2.3.Organizimi i seancave orientuese dhe shpjegimi i politikave, procedurave, proceseve të punës me qëllim të ofrimit të ndihmës për nëpunësit e rinj të sapo emëruar që të familjarizohen me rolet dhe përgjegjësitë e tyre;

2.4.Mbajtja e të dhënave të sakta dhe të përditësuara të punonjësve si dhe menaxhimi i tyre përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e dhënave personale;

2.5.Administrimi i kompensimit të punonjësve, përfshirë pagat, shtesat, kujdestaritë, shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera, si dhe menaxhimi i pensioneve dhe i pushimeve të punonjësve;

2.6.Mbështetje e zbatimit të proceseve të vlerësimit të rezultateve në punë për punonjësit duke ofruar formularë, udhëzime dhe sqarime për procesin e vlerësimit;

2.7. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe organizimi i programeve përkatëse të trajnimit, zhvillimi i materialeve dhe burimeve të trajnimit për rritjen e aftësive të punonjësve dhe zhvillimin e karrierës;

2.8.Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve midis punonjësve, adresimi i ankesave dhe shqetësimeve të tyre dhe promovimi i një mjedisi pune pozitiv dhe gjithëpërfshirës si dhe mbështetja e Komisioneve disiplinore dhe ankesave;

2.9.Përgatitja e planit vjetor dhe planit afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit vjetor të buxhetit të QKKTGJ-së si dhe raportin vjetor për gjendjen e shërbimit publik në QKKTGJ.

3.Divizioni për Burime Njerëzore, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGJ-së.

4.Numri i të punësuarve në Divizionin për Burime Njerëzore është tre (3).

Neni 43

Divizioni për Buxhet dhe Financa

1.Misioni i Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përbashkëta është të sigurojë menaxhimin efektiv dhe transparent të burimeve financiare dhe materiale të QKKTGJ -së , për të mbështetur realizimin e misionit dhe objektivat e QKKTGJ-së.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Buxhet dhe Financa, janë:

- 2.1. Planifikimi i buxhetit në koordinim me njësitë përkatëse në kuadër të QKKTGj-së dhe përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në harmoni me kërkesat e njësive buxhetore;
 - 2.2. Bashkërendimi me Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me buxhetin dhe të hyrat e QKKTGj-së si dhe regjistrimin e të hyrave dhe të donacioneve të ndryshme dhe inkorporomi i tyre në buxhetin sipas legjislacionit përkatës;
 - 2.3. Përgatitja e analizave buxhetore si dhe raporteve mbi shpenzimin e buxhetit dhe monitorimi i realizimit të projekteve të cilat janë të lidhura me buxhetin e QKKTGj-së;
 - 2.4. Përgatitja e planit rrjedhjes të parasë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e përcaktuara si dhe sigurimi që zotimet dhe shpenzimet janë bërë në përputhje me rregullat financiare;
 - 2.5. Ofron mbështetje për ndikimin buxhetor për propozimin e politikave nga fushëveprimi i QKKTGj-së;
 - 2.6. Zotimi i mjeteve për realizimin e pagesave për projekte/aktivitete si dhe menaxhimi i lidhshmërisë së mjeteve të alokuara, atyre të shpenzuara dhe të zotuar gjatë vitit fiskal;
 - 2.7. Administrimi i pasurive të QKKTGj-së, duke përfshirë QTGj-të rajonale, përmes regjistrimit, mirëmbajtjes dhe azhurnimit të të dhënave për të gjitha asetet e tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret në fuqi;
 - 2.8. Përgatitja e pasqyrave financiare në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë dhe sigurimi i kontrollit të brendshëm financiar në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Divizioni për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGj-së.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Buxhet dhe Financa është pesë (5).

Neni 44 **Divizioni Ligjor**

1. Misioni i Divizionit Ligjor është të ofrojë mbështetje ligjore, të sigurojë respektimin e ligjeve dhe të mbrojë interesat e QKKTGj-së dhe njësive të saja, përfshirë ofrimin e këshillave ligjore, hartimin dhe rishikimin e akteve të përgjithshme të QKKTGj-së si dhe avokimin për të drejtat ligjore të QKKTGj-së dhe QTGj-ve rajonale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Ligjor, janë:
- 2.1. Ofrimi i mbështetjes ligjore për QKKTGj-në dhe QTGj-të rajonale, përfshirë, këshilla ligjore, lidhur me zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe urdhëresave, për t'u siguruar që funksionimi, vendimmarrja është në përputhje me ligjin;
 - 2.2. Hartimi i rregulloreve, urdhëresave, marrëveshjeve, procedurave dhe kontratave për QKKTGj-në dhe QTGj-të rajonale si dhe rishikimi i tyre për të siguruar ligjshmërinë dhe përafrimin e tyre me ligjet përkatëse;

- 2.3. Bashkëpunon me Ministrinë e shëndetësisë dhe Ministrinë e drejtësisë/Avokaturën shtetërore për përfaqësimin e QKKTGJ-së dhe QKTGj-të rajonale për kontestet ligjore;
 - 2.4. Monitorimi i ndryshimeve në ligjet dhe rregulloret që mund të ndikojnë në fushëveprimin e QKKTGJ-së si dhe këshillimi i menaxhmentit për rishikimin dhe përshtatjen e tyre;
 - 2.5. Përgatitja e mjeteve juridike për kontestet administrative dhe gjyqësore të QKKTGJ-së;
 - 2.6. Ofrimi i ekspertizës ligjore në çdo rast kur konsiderohet e nevojshme dhe mbështetja juridike sipas nevojave që mund të paraqiten;
 - 2.7. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit lidhur me QKKTGJ -në dhe QRShP-të, akteve të brendshme dhe vendimeve si dhe përgatitja e raporteve periodike dhe sipas kërkesës.
3. Divizioni Ligjor, udhëhiqet nga udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGJ-së.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin Ligjor është tre (3).

Neni 45

Divizioni për Prokurim Publik

1. Misioni i Divizioni për Prokurim Publik është të sigurojë blerjen efikase dhe me kosto efektive të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme duke respektuar drejtësinë, transparencën dhe pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikave përkatëse të QKKTGJ-së, si dhe standardeve etike.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Prokurim Publik, janë:
 - 2.1. Identifikimi i nevojave të QKKTGJ-së për mallra, shërbime dhe punë dhe përgatitja e planit vjetor të prokurimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet e QKKTGJ-së;
 - 2.2. Përgatitja dhe lëshimi i dokumenteve të prokurimit si kërkesat për propozime, kërkesat për kuotime dhe ftesat për ofertë dhe mbledhja e tyre;
 - 2.3. Përcaktimi i metodologjisë së prokurimit dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve dhe vlerësimi i ofertave dhe propozimeve për të zgjedhur furnizuesit më të përshtatshëm bazuar në kriteret si çmimi, cilësia dhe aftësia;
 - 2.4. Negocimi dhe finalizimi i kontratave me furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve të përzgjedhura dhe sigurimi që kontratat janë të qarta, dhe në përputhje me legjislacionin, politikat dhe rregulloret e QKKTGJ-së;
 - 2.5. Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve pozitive me furnitorët, punë kryerësit dhe shitësit si dhe rishikimi i rregullt i performancës së furnitorëve për të vlerësuar aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat e cilësisë, ofrimit dhe shërbimit;
 - 2.6. Bashkëpunimi me furnitorët për të përmirësuar proceset, cilësinë dhe efikasitetin si dhe adresimi i çdo çështjeje ose mosmarrëveshjeje kontraktuale;

- 2.7. Planifikimi dhe koordinimi i shpërndarjes së mallrave dhe materialeve në njësitë përbërëse të QKKTGJ-së;
- 2.8. Sigurimi që të gjitha aktivitetet e prokurimit respektojnë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe menaxhimi i dokumentacionit dhe regjistrimeve për proceset e prokurimit për qëllime auditimi;
- 2.9. Zbatimi i praktikave më të mira, etike dhe transparente të prokurimit për të parandaluar korrupsionin dhe favorizimin, ulur kostot dhe për të rritur efektivitetin e përgjithshëm;
- 2.10. Sigurimi i trajnimeve dhe udhëzimeve për stafin e prokurimit të përfshirë në proceset e prokurimit për të siguruar që ata të kuptojnë dhe ndjekin procedurat e duhura.
3. Divizioni për Prokurim Publik, udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të QKKTGJ-së.
4. Numri i të punësuarve në Divizion për Prokurim Publik, është tre (3).

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 46

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të kësaj Rregulloreje.
2. Lëvizshmëria e personelit brenda institucionit bëhet në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
3. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin e Buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen njësitë organizative.
4. Pranimi i personelit të parashikuar me këtë Rregullore për të cilin nuk ekziston buxhet aktual do të bëhet pas sigurimit të buxhetit me ligjin vjetor të buxhetit.
5. Shtojca Nr.1, që përmban klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Shtojca Nr. 2, që përmban organogramin, janë pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

Neni 47

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat që rregullojnë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në QKKTGJ.

Neni 48

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së

Kosovës.

Arben VITIA

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë

26.03.2025

Shtojca Nr. 1 - Klasifikimi dhe sistematizimi i pozitave (organika)

Struktura/Pozita	Kategoria dhe Klasa sipas LZP-së	Klasa sipas LPSP-së	Koeficienti	Grupi i pozitave	Numri ekzekutuesve
1. ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV					Totali: 2
Drejtues i Ekzekutiv	Drejtues i Lartë 2	H2	13.4		1
Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Pozitat dhe strukturat nën varësi të Drejtorit Ekzekutiv					Totali: 1
Zyrtar i Lartë Certifikues	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i ekonomisë	1
1.1 Divizioni për Burimeve Njerëzore					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Burimeve Njerëzore	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar për Burime Njerëzore dhe Paga	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i burimeve njerëzore	1
Zyrtar për Burime Njerëzore	Profesional 1	I15	5.1	Grupi i burimeve njerëzore	1
1.2 Divizioni Ligjor					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit Ligjor	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar Ligjor	Profesional 1	I15	5.1	Grupi ligjor	2
1.3 Divizioni për Buxhet dhe Financa					Totali: 5
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar për Buxhet dhe Financa	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar për të Hyra	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar i Lartë i Pasurisë	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i ekonomisë	1
Asistent për Arkë /Inkasantë	Profesional 3	I18	4	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
1.4 Divizioni për Shërbime të Përbashkëta					Totali: 11
Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përbashkëta	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar për Arkiv	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i burimeve njerëzore	1
Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i teknologjisë informative	1
Zyrtar për Depo dhe Logjistik	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Asistent Administrativ	Profesional 3	I18	4	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
Shtëpiak	NTM3	I23	3.76		1
Pastrues/Hixhieniste	NTM3	I23	3.76		4

1.5 Divizioni për Prokurim Publik					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Prokurim Publik	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar për Prokurim	Profesional 2	I15	5.1	Grupi i prokurimit publik	1
Asistent për Prokurim	Profesional 3	I18	4	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2. DEPARTAMENTI PËR GRUMBULLIM DHE PROMOVIM TË DHURIMIT TË GJAKUT					Totali: 11
Drejtori i Departamentit për Grumbullim dhe Promovim të Dhurimit të Gjakut	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
2.1 Divizioni për Promovimin e Dhurimit të Gjakut dhe Këshillimin e Dhuruesve					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Planifikimin dhe Promovimin e Dhurimit Vullnetar të Gjakut	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Zyrtar i Lartë për Promovim të Dhurimit të Gjakut	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Zyrtar i Lartë për Këshillimin të Dhuruesve të Gjakut	Profesional 1	I13	5.7	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
2.2 Divizioni për Grumbullimin e Gjakut					Totali: 6
Udhëheqës i Divizionit për Grumbullimin e Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	3
3. DEPARTAMENTI PËR AFEREZË					Totali: 8
Drejtori i Departamentit për Aferezë	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
3.1 Divizioni për Dhurimin e përbërësve të gjakut me Aferezë					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Dhurimin e përbërësve të gjakut me Aferezë	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
3.2 Divizioni për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit					Totali:

					3
Udhëheqës i Divizionit për Transfuzion Autolog dhe Format tjera të Dhurimit	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
4. DEPARTAMENTI PËR NDARJEN DHE PËRPUNIMIN E GJAKUT					Totali: 8
Drejtor i Departamentit për Ndarjen dhe Përpunimin e Gjakut	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
4.1 Divizioni për Ndarje Konvencionale të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Ndarje Konvencionale të Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
4.2 Divizionit për Ndarje Speciale të Gjakut dhe Zinxhirin e Ftoftë					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Ndarje Speciale dhe Zinxhirin e Ftoftë	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
5. DEPARTAMENTI PËR TRANSFUZIONIN KLINIK TË GJAKUT					Totali: 12
Drejtori i Departamentit për Transfuzionin Klinik të Gjakut	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
5.1 Divizioni për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut					Totali: 7
Udhëheqës i Divizionit për Interreaksione dhe Përdorim Klinik të Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	3
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	3

5.2 Divizioni për Hemovigilencë dhe Shpërndarje të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Hemovigilencë dhe Shpërndarje të Gjakut	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
6. DEPARTAMENTI PËR IMUNOHEMATOLOGJI					Totali: 8
Drejtori i Departamentit për Imunohematologji	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
6.1 Divizioni për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testimin Imunohematologjik të Dhuruesve të Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel teknik Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
6.2 Divizioni për Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit Testimin Molekular të Grupeve të Gjakut dhe Rasteve Problematike	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
7. DEPARTAMENTI PËR SËMUNDJET E TRANSMETUESHME					Totali: 8
Drejtori i Departamenti për Sëmundjet e Transmetueshme	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4		1
7.1 Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Dhuruesve të Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1

Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
7.2 Divizioni për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testimin e Sëmundjeve të Transmetueshme të Pacientëve	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
8. DEPARTAMENTI PËR TESTIME PRENATALE					Totali: 8
Drejtori i Departamentit për Testime Prenatale	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
8.1 Divizioni për Testime Prenatale					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testime Prenatale	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
8.2 Divizioni për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testime Imunohematologjike për Pacientët Klinik	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
9. DEPARTAMENTI PËR HEMOSTAZË					Totali: 8
Drejtori i Departamenti për Hemostazë	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
9.1 Divizioni për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testimin e Çrregullimeve të Hemostazës dhe Koagulopative	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1

	Mjekësorë 1				
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
9.2 Divizioni për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testimin e Produkteve të Ngrira të Gjakut	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
10. DEPARTAMENTI PËR KONTROLLIN E CILËSISË DHE SIGURISË SË PRODUKTEVE TË GJAKUT					Totali: 8
Drejtori i Departamenti për Kontrollin e Cilësisë dhe Sigurisë së Produkteve të Gjakut	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
10.1 Divizioni për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Kontroll të Cilësisë dhe Mikrobiologjisë	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
10.2 Divizioni për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive -NAT					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Testime Molekulare të Sëmundjeve Infektive - NAT	Drejtues i Ulët 1	H5	12.3		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
11. DEPARTAMENTI PËR INFERMIERI					Totali: 8
Drejtori i Departamenti për Infermieri	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
11.1 Divizioni i Infermierisë për QKKTGj					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Infermieri në QKKTGj	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel	H15	5.6	Grupi i shërbimeve	1

	teknik Mjekësorë 1			teknike shëndetësore	
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
11.2 Divizioni i Infermierisë në Qendrat e Transfuzionit të Gjakut					Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Infermieri në QTGj	Drejtues i ulët	I10	7.35		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
1.QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË PRIZREN					Totali: 11
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjakut në Prizren	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Personel mjekësor	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	2
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	5
Pastrues/Hixhieniste	NTM3	I23	3.76	Grupi për shërbimet e mirëmbajtjes	1
2. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË PEJË					Totali: 12
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjakut në Pejë	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	3
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	6
3. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË MITROVICË					Totali: 10
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjakut në Mitrovicë	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1

Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	5
Pastrues/Hixhieniste	NTM3	I23	3.76	Grupi për shërbimet e mirëmbajtjes	1
4. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË FERIZAJ					Totali: 8
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjaku në Ferizaj	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	4
5. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË GJILAN					Totali: 9
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjaku në Gjiilan	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	5
6. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË GJAKOVË					Totali: 12
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit Gjaku në Gjakovë	Drejtues i Mesëm	H4	12.5		1
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12		1
Teknik Laborant/Infermiere (bachelor)	Personel teknik Mjekësorë 1	H15	5.6	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	2
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personel teknik Mjekësorë 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	7
7. QENDRA E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË VUSHTRI					Totali: 4
Drejtori i Qendrës së Transfuzionit	Drejtues i	H4	12.5		1

Gjakut në Vushtrri	Mesëm				
Kryeinfermier 1	Drejtues i Ulët 4	H12	6.4	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1
Mjek Specialist i Transfuziologjisë	Personel Mjekësorë 1	H8	12	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	1
Teknik Laborant/Infermiere (shkolla e mesme)	Personeli Teknik Mjekësor 4	H18	5.3	Grupi i shërbimeve teknike shëndetësore	1

Shtojca Nr.1 - Organogrami i
Qendrës Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
(QKKTGJ)

